



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100452/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë nr.3,
Tiranë.

Drejtuar: Z. Edmond MESHINI
Shef i Komisarariatit të Policisë nr.3 Tiranë

TIRANË

Për dijeni: Drejtues i parë Rebani JAUPI
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

I nderuar z. Meshini,

Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisariatin e Policisë nr.3 Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 12.03.2021, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe znj.Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, procedurën standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e rendit (në mungesë të shefit të komisariatit) z.Agron Dosti, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i rendit informoi grupin e inspektimit, për gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të këtij komisariati, masat e marra për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i monitorimit, pasi mori informacionin e nevojshëm inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Gjatë inspektimit, ju kushtua vëmendje e veçantë edhe zbatimit të masave të protokollit shëndetësor për parandalimin e COVID-19 në mjediset e komisariatit. U evidentua se, punonjësit e policisë ishin të pajisur me maska mbrojtëse dhe ruanin distancën fizike me njëri tjetrin. Në vende të aksesueshme (koridore) ishin vendosur pajisje me dezinfektant për pastrimin e duarve. Gjithashtu, dezinfektantë për pastrimin e duarve ishin vendosur edhe në korridorin ku ndodhej ambienti i sigurisë dhe ai i shoqërimit, si dhe në zyrat e punës të punonjësve të policisë.

Maskat mbrojtëse dhe dezinfektantët ishin siguruar nga DVP Tiranë, si dhe në formë donacioni nga subjekte private. Ambientet e punës, automjetet e patrullave, si dhe ambienti i shoqërimit dhe i sigurisë, ishin dezinfektuar nga një subjekt privat i kontraktuar nga DVP Tiranë, në çdo 10 ditë sipas një grafiku të miratuar.

Shefi i rendit të komisariatit dhe punonjësit e policisë me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues dhe transparentë, gjatë inspektimit në ambientet e këtij komisariati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se:

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës për intervistim e fëmijëve të mitur në konflikt me ligjin.
2. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar, që në momentin e shoqërimit në mjediset e këtij komisariati.

Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:

1. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen e dhomave të sigurisë me krevat për fjetje, duke krijuar kushte të përshtatshme për jetesë të shtetasve të arrestuar/ndaluar.
2. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e ambientit të shoqërimit me dhoma të ndara më vehte për personat e rritur, femra dhe të mitur.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Në përfundim të inspektimit, u konstatua se në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisarjatin e Policisë Nr.3 në Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Ambienti i shoqërimit në Komisarjatin e Policisë nr.3, Tiranë, **nuk** është i ndërtuara sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, në dhoma të ndara më vehte për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit.¹

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës të komisarjatis dhe kishte 2(dy) dhoma shoqërimi. Dhoma e shoqërimit për të rriturit ishte me përmasa 4x2m, ndërsa dhoma e shoqërimit për femra dhe të mitur ishte me përmasa 4x3m. Çdo dhomë ishte e plotësuar me nga 2 karrige për qëndrimin ulur të shtetasve, të cilat ishin me këmbë të fiksuara në dysheme, por ato ishin të dëmtuara dhe të konsumuara. Kapaciteti i deklaruar i dhomave ishte për mbajtjen dhe qëndrimin e deri 10 personave të shoqëruar. Numri i karrigeve (stolave) nuk i përgjigjej kapacitetit që kanë dhomat e shoqërimit. Nëse ato ishin me kapacitet mbi 4 persona, do të duhej të rrinin në këmbë ose ulur përtok, që qartazi nuk plotëson standardin e trajtimit njerëzor të personave të shoqëruar.

Nga statistikatat e nxjerra nga regjistri për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar, rezultoi se për periudhën Janar – Mars 2021 ishin shoqëruar gjithsej 282 shtetas. Sipas treguesve, ambienti i shoqërimit ka kapacitete për qëndrimin e të shoqëruarve, por në rastin kur numri i të shoqëruarve është i madh, si në rastin e ndalimeve nga punonjësit e policisë gjatë protestave të zhvilluara në Tiranë, në këto ambiente janë konstatuar nga inspektimet tona, se ka patur mbipopullime dhe trajtim jo dinjitoz të shtetasve.

Dritarja e dhomës ku qëndronin të shoqëruarit në moshë madhore, ishte me përmasa të vogla dhe **nuk** krijonte mundësi për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Ndërsa, dhoma ku qëndronin shtetasit e shoqëruar femra dhe të mitur, ishte me dritare me përmasa normale që lejonte ajrimin dhe futjen e dritës natyrale. Ato kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë hekuri. Xhamat e dritareve u konstatuan se ishin të thyera, por sipas shënimeve në regjistrin që mbahej nga punonjësit e informacionit, ato ishin thyer ditët e fundit nga persona që kishin qëndruar në këto ambiente.

Dhomat e shoqërimit ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare, por ato kishin nevojë për lysterje dhe dezinfektim të herë pas herëshëm, pasi ndihej era e rëndë dhe muret e dhomave ishin me shkrime dhe të dëmtuara nga personat që kishin qëndruar brenda tyre.

Dyert e dhomave ishin prej druri të veshura me llamarinë dhe mbylleshin nga jashtë me shul dhe çelës. Mjedisi i shoqërimit dhe ambientet e tjera të komisarjatis nuk kishin sistem qëndror për ngrohjeje. Në koridorin e ambientit të shoqërimit, kishte një tualet i cili kishte ujë të rrjedhshëm dhe përdorej nga të shoqëruarit.

¹ Kreu VI, pika 3 e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Në ambientin dhe dhomat e shoqërimit të komisariatit, ishin të instaluar kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe të dhomave në mjedisin e shoqërimit, të cilat monitoroheshin nga punonjësit e policisë, nëpërmjet kompjuterit i cili ndodhej në zyrën e informacionit. Administrimi pamjeve filmike kryhej nga DPSH.

Në dhomat e shoqërimit nuk u konstatuan sende apo mjete të tilla, të cilat mundet të shërbenin për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar në ambientet e këtij komisariati.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Ambienti i sigurisë në Komisaratin e Policisë nr.3, Tiranë, në tërësi **nuk** ishte i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të ndërtesës të komisariatit dhe kishte 3(tre) dhoma sigurie, nga të cilat vetëm 1(një) dhomë ishte funksionale. Dy dhomat e tjera, ishin të mbyllura e të vulosura, sipas rekomandimeve të CPT-së gjatë vizitës inspektuese të zhvilluar në vendin tonë në vitin 2018, pasi nuk ato plotësonin parametrat teknikë dhe jetësor për ndërtimin e dhomave të sigurisë.

Dhoma e sigurisë ishte me përmasa 4x2m dhe me kapacitet për mbajtjen dhe sigurimin e 3(tre) personave të ndaluar/arrestuar në moshë madhore. Në rastet e ndalimit/arrestimit të personave femra dhe të mitur, në përfundim të veprimeve procedurale shoqëroheshin menjëherë për në dhomat e sigurisë të DVP Tiranë.

Nisur nga sipërfaqe dhe kubatura e dhomës të sigurisë, ajo nuk plotëson normat dhe parametrat teknikë dhe jetësorë për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra katrorë dhe jo e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².²

Dritarja e dhomaës të sigurisë ishte e vogël dhe nuk mundësonte futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Komisarati siguronte ndriçim nga rrjeti elektrik në mënyrë të pandërprerë dhe kishte gjenerator si burim rezervë energjie në rast ndërprerje të energjisë elektrike në ambientin e sigurisë dhe të shoqërimit.

Dhoma e sigurisë, për shkak se godina kishte vite që është e ndërtuar dhe e amortizuar, është e nevojshme kryerja e një rikonstruksioni të pjesshëm për suvatimin e mureve të brendshëm të saj. Megjithëse dhoma mbahej pastër nga ana higjieno-sanitare, ajo kishte nevojë për lyerje dhe dezinfektim të herëpashershëm.

Dhoma e sigurisë kishte vetëm një krevat me sustë, ndërsa për dy personat e tjerë kishte dyshekë të vendosur në dyshtenë e shtruar me dërrasë. Gjithashtu dhoma, ishte e

² *Kreu V, pika 3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

kompletuar me materiale për fjetje si batanie dhe jastek, të cilat ishin në gjendje të mirë përdorimi.

Nisur nga fakti që, 2 nga personat e ndaluar/arrestuar flinin me dyshekë në dysheme dhe gjendja teknike e dhomës së sigurisë ishte e amortizuar, mbyllja e dy dhomave të tjera të sigurisë nuk i ka përmirësuar por i ka përkeqësuar standardet e trajtimit të personave të ndaluar/arrestuar që mbahen në ambientin e sigurisë të komisariatit.

Gjate inspektimit, në dhomën e përgjegjësit të sigurisë u gjetën sende që nuk janë të lejueshme si çekiç dhe një shufër metalike, të cilat vizualisht shkaktonin dhe ekspozonin dhunë psikologjike te personat që hynin në këtë ambient. Nga intervista e zhvilluar me përgjegjësën e dhomave të sigurisë, u konkludua se asnjë nga personat e ndaluar apo të arrestuar nuk hynin në këtë dhomë ku mbahej dokumentacioni, pasi ai është ambient pune vetëm i përgjegjësit të dhomave të sigurisë. Gjithashtu, ato shërbeni si mjete pune për rregullimin e dyerve dhe të dritareve, të cilat dëmtoheshin shpesh nga personat që qëndronin në dhomat e sigurisë dhe të shoqërimit.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej një tualet e cila ishte e pajisur me lavaman, çezëm dhe nyje hidrosanitare, si dhe furnizohej rregullisht me ujë të rrjedhshëm. Personat ndaluar/arrestuar kishin akses sa herë që e shikonin të nevojshme për mbajtjen e higjienës personale dhe ambientit të dhomës. Brenda në ambientin e tualit ishte instaluar edhe dushi me ujë të ngrohtë, që shërbente për larjen e trupit.

Ambienti i sigurisë nuk kishte sistem ngrohje me kaldajë për dimër, por institucioni kishte siguruar pajisje elektrike për ngrohje, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në ambientin e sigurisë mungonte aparati telefonik fiks që përdoret nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda nga të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë apo ndërhyrje të shpejtë. Ndërsa, në dhomën e sigurisë kishte një buton me zile/sinjali, që ju shërben personave të ndaluar/arrestuar për njoftimin e punonjësit të shërbimit, në rast nevojë.

Ambienti i sigurisë kishte vetëm një dhomë e cila shërbente njëkohësisht si dhomë për kryerjen e vizitave mjeksore, dhomë për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të ndaluar/arrestuar nga OPGJ apo prokurorët, si dhe për takime me avokatët mbrojtës. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, por mungonte krevati për kryerjen e vizitave mjeksore, si dhe rafti për ruajtjen e paketave të ilaçeve për rastet e emrgjencave. Ky ambient është në kundërshtim me standardet që kërkohen për ndërtimin e dhomave të sigurisë, pasi referuar procedurës standarde dhomat duhet të jenë të ndara më vete sipas funksionit që ato kanë.

Veç masave për ruajtjen fizike, ambienti i sigurisë mbahej në vëzhgim dhe nga sistemi i kamerave, të cilat ishin instaluar në korridorin ku ndodhej ambienti i sigurisë dhe shoqërimit, në hyrje të dhomës së sigurisë, si dhe në pjesën e jashtme për mbajtjen nën vëzhgim të territorit të komisariatit. Ky sistem funksiononte përgjatë 24 orëve, pamjet filmike ruheshin deri 30 ditë. Dhoma për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nuk monitorohej me sistemin e kamerave.

Për periudhën Janar – Mars 2021, referuar regjistrimit për evidentimin e të dhënave të të ndaluarve/arrestuarve, në dhomën e sigurisë kanë qëndruar 60 persona. Kjo statistikë, për

këtë periudhë është brenda kapaciteteve që ka dhoma e sigurisë, por në rastet e shoqërimit apo arrestimeve masive të kryera nga punonjësit e policisë (rasti i protestave të zhvilluara në muajin Dhjetor 2020), nga ekspertët e Institucionit të Avokatit të Popullit, janë konstatuar mbipopullime dhe trajtime jo dinjitoze të protestuesve. Ky është një problem serioz dhe kërkon zgjidhje të menjëhershme për zgjerimin e kapaciteteve të dhomave në komisariatet e policisë, nëpërmjet krijimit të dhomave të reja të shoqërimit dhe të sigurisë, ashtu edhe në plotësimin e tyre me orenditë e nevojshme me kushte të përshtatshme dhe dinjitoze për qëndrimin dhe akomodimin e shtetasve në këto ambiente, në bazë të urdhërave të ndalimit apo vendimeve të formës së prerë të gjykatave. Në këto kushte, Institucioni jonë inkurajon përfundimin e bllokut/godinës të sigurisë për DVP Tiranë, brenda muajit Dhjetor 2021 që është edhe afati kontraktual me subjektin ndërtues.

Në momentin e inspektimit ndodhej vetëm 1(një) person në dhomën e sigurisë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisaratin e Policisë nr. 3, Tiranë, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, sipas procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit dhe ishte i sekretuar e i plotësuar sipas rubrikave.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, regjistri ishte i sekretuar dhe rubrikat e tij ishin plotësuar me korrektesë dhe përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Ndërkohë, gjatë ditëve të protestave të zhvilluara në muajin Dhjetor 2020, grupet e inspektimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, kanë konstatuar vonesa dhe parregullsi nga punonjësit e policisë të komisarariatit, në plotësimin e menjëhershëm të regjistrit të të shoqëruarve, si dhe në njoftimin e familjarëve të tyre, që në momentin që këta persona hyjnë në mjediset e policisë. Kjo situatë, nuk mund të justifikohet me fluksin e madh të të shoqëruarve apo të ndaluarve/arrestuarve, pasi përbën shkelje të rëndë të të drejtave që ju gantohen këtyre personave në mjediset e policisë. Por, në këto situata, kërkohet një menaxhim propocional i forcave të policisë mes atyre që janë në terren dhe atyre që duhet të qëndrojnë në ambientet e komisarariatit për trajtimin e të shoqëruarve, sipas të gjitha të drejtave që ju garantojnë aktet ligjore dhe ato ndërkombëtare për këtë qëllim.

Personat e ndaluar apo të arrestuar që mbahen, trajtohen dhe sigurohen në ambientet e sigurisë në këtë komisarariat, iu evidentohen të dhënat në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektesë në të gjitha rubrikat e tij.

Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit që në momentin kur atyre personave ju privohet liria në mjediset e policisë. Kjo u evidentua nga grupi i inspektimit gjatë kqyrjes së fashikujve të arrestimit apo ndalimit të personave, si dhe regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar, që ndodheshin në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

Gjithashtu, komisariati kishte regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, si dhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Për periudhën e inspektimit nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë nga ana e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në mjediset e këtij komisariati.

Në dhomën e përgjegjësit të sigurisë, mbaheshin të gjithë regjistrat dhe librat që janë të parashikuara në procedurën standarde kreu XI, pika 1 “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, të cilët ishin të plotësuar sipas rubrikave dhe ishin të sekretuar.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë

Në kohën e inspektimit në ambientin e shoqërimit në Komisarlatin e Policisë nr. 3 Tiranë nuk kishte asnjë person të shoqëruar. Ndërsa në dhomën e sigurisë ndodhej vetëm një shtetas, pranuar në cilësinë e personit të ndaluar.

Grupi i inspektimit intervistoi personin ndaluar, i cili konfirmoi se ishte trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së marrjes në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore dhe ditëve të qëndrimit në ambientin e sigurisë.

Nga intervista rezultoi se, personi i ndaluar kishte dijeni për identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishte marrë kontakt dhe kishte kryer veprimet procedurale. Ai deklaroi se, gjatë shoqërimit dhe ndalimit nga punonjësit e policisë, ata ishin identifikuar duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Personi ishte i pajisur me setin e dokumentave si kopje e urdhërit të ndalimit, procesverbal të kontrollit dhe sendeve personale, si dhe kopje me kartën e të drejtave të personave të ndaluar/arrestuar.

Nga i intervistuari nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja psikologjike ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për pasoja të shkaktuara nga keqtrajtimi.

Koha e qëndrimit të personit të shoqëruar dhe i ndaluar në ambientin e sigurisë ishte brenda afatit ligjor të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale. Por, nga punonjësit e shërbimit në ambientin e sigurisë, u ngrit si shqetësim për vonesat e transferimit të personave të dënuar me vendim të formës së prerë apo me masë sigurie “arrest në burg”, për në IEVP.

Sipas dokumentacionit të verifikuar nga grupi i inspektimit, kërkesa nga organi i policisë ishte kryer brenda ditës, me përfundimin e veprimeve procedurale. Ndërsa, nga ana Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kishte vonesa në ekzekutimin e këtyre vendimeve penale sa më parë, sikurse përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale, praktikë e gjetur edhe si shkelje edhe nga ana e CPT (European Committee for the Prevention of Torture), në raportin e fundit të botuar për Shqipërinë.³

³ Raporti CPT botuar mw 17 shtator 2019. <https://rm.coe.int/168097986b>

Në këtë raport, rekomandohet se *“Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje për t'i dhënë fund praktikës së mbajtjes në arrest policor të personave me masë sigurie "arrest në burg" dhe të dënuarit me burgim me një vendim të formës së prerë”*.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, institucionet shtetërore përgjegjëse, gjegjësisht Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 “Për transferimin në IEVP të të ndaluarve me masën e sigurisë “paraburgim” dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë, ku përcaktohen procedurat dhe afatet për transferimin e këtyre personave jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit⁴. Por, sikurse rezultoi nga kontakti me drejtuesit e policisë të komisariatit, ky shqetësim vazhonte të ishte prezent dhe marrëveshja e bashkëpunimit, ende nuk kishte gjetur zbatim në praktikë

Nga intervista me personin e ndaluar, si dhe informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë me shërbim catering që ofrohej nga subjekt privat, sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr. 432, datë 10.03.2008 të Ministrisë të Brendshëm dhe Ministrisë të Shëndetësisë.

Ndonëse në ambientin e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomës të sigurisë ose në koridorin e ambientin të sigurisë.

Gjithashtu, gjatë periudhës së pandemisë të ndaluarve/arrestuarve iu jepeshin produkte mbi normativën mujore për mbajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit dhomave si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës, si dhe dezinfektantë për mbrojtje nga COVID-19.

Ambientet e intervistimit

Në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë nr. 3 Tiranë kishte një dhomë që shërbente për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e organit të prokurorisë, e cila shërbente njëkohësisht dhe për takime me avokatët. Dhoma ishte e pajisur me tavolinë dhe karrige, ndërsa dritarja ishte e siguar me rrjetë hekuri në pjesën e jashtme të saj. Dhoma nuk ishte e monitoruar me sistemin audio-viziv të kamerave.

Ndërsa të shoqëruarit në mjediset e policisë, intervistoheshin në zyrat e punës të punonjësve të policisë, njëkohësisht ju komunikoheshin dhe masa e sigurisë para se të kalonin në ambientet e sigurisë. Zyrat e punës të punonjësve të policisë, nuk ishin të monitoruara me sisteme e kamerave për të vëzhguar veprimet procedurale që kryejnë me personat e shoqëruar.

⁴ Rekomandimi 1, faqe 8, përgjigje e Qeverisë Shqiptare në lidhje me rekomandimet e CPT.
<https://rm.coe.int/16809cb571>

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre, por konstatohet se ky rekomandim nuk është plotësuar⁵.

Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisariat ishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale.

Nga inspektimi u evidentua se, në këtë komisariat ishte krijuar një ambient me dy dhoma për intervistimin e të miturve, me ambiente të ndara dhe të pajisura me orënditë e nevojshme, sipas parashikimeve ligjore. Ky investim ishte në përfundim, por ende nuk ishte marrë në dorëzim dhe nuk ishte vënë në funksionim. Intervistimi i të miturve dhe i grave ende kryhej në zyrat e punonjësve të policisë.

Gjithashtu, grupi i monitorimit asistoi në një seancë intervistimi nga oficerja e policisë gjyqësore të një vajzë e mitur, ku të pranishëm ishin kujdestari ligjor (babi i saj) dhe psikologjia e DVP Tiranë.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Në Komisarlatin e Policisë nr.3, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kreu VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjatë inspektimit, u bë kqyrja e dokumentacionit që ndodhej në zyrën e informacionit ku rezultoi se, ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”, si dhe zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të K.Pr.P, që personit të ndaluar/arrestuar duhet t’i jepet dhe të mbajë me vete një kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Gjatë intervistimit të personit të ndaluar dhe nga informacioni i punonjësve të policisë rezultoi se, personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar madhor njoftoheshin që në mungesë të mundësive financiare mund të kërkonin mbrojtje apo ndihmë juridike falas, duke ju ofruar një avokat kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në ambientin e dhomës të përgjegjësit të dhomave të sigurisë.

⁵ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarariat e Policisë nr. 3 Tiranë ishin të afishuara postera me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar.

Ndërsa për shtetasit e huaj të ndaluar/arrestuar, ishin përgatitur deklaratat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në ambientin e sigurisë, lista e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre. Ndërsa psikologu ofrohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.

Personave të ndaluar/arrestuar iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe të letrës me të drejtat e tyre. Informacioni i dhënë nga punonjësit e policisë u konfirmua edhe nga intervista me personin që ndodhej në ambientin e sigurisë gjatë kryerjes së inspektimit.

Grupi i inspektimit konstatoi se, vizitat mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar bëheshin nga ana e mjeku brenda afatit 12 orësh nga momenti i pranimit të këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në procedurën standarde për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar.⁶

Mjeku që kryente vizitat mjekësore ishte në organikë DVP Tiranë dhe ishte i punësuar me kohë të plotë. Veprimet e kryera nga mjeku, rekomandimet për vizita mjekësore dhe medikamentet që duhet të përdornin të ndaluarit/arrestuarit në rast nevojë, pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore dhe kartelën mjekësore të secilit person. Kartela mjekësore ishte pjesë e dokumenteve të fashikullit për çdo të ndaluar/arrestuar, sipas procedurave standarde dhe rekomandimeve të CPT në këtë pikë.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e kushteve të përshtatshme për jetesë në ambientin e sigurisë, duke pajisur me krevat më vete çdo person të ndaluar/arrestuar. Deri në ndërtimin e godinës/bllokut të sigurisë për strukturat e DVP Tiranë, në dhomën e sigurisë të Komisarariatit nr.3, të mos mbahen persona të ndaluar/arrestuar më shumë se kapaciteti fizik.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për marrjen në dorëzim dhe vënien në funksionim të ambientit për intervistim e të miturve në konflikt me ligjin.

⁶ *Kreu V, pika 7.2 e procedurës standarde për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar.*

3. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin më vete të zyrës ku merren në pyetje personat e ndaluar/arrestuar, si dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera brenda saj, për monitorimin e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për lyerjen e dezinfektimin e vazhdueshëm të dhomës dhe në tërësi ambientin e sigurisë.
5. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin më vete të dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore, të pajisur me orënditë e nevojshme si tavolinë pune, karrige, krevat, një raft për mbajtjen e dokumenteve dhe medikamenteve, si dhe një frigorifer të vogël për ruajtjen e ilaçeve.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për trajnimin e punonjësve të policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit, për mënyrën e plotësimit me saktësi të regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar në mjediset e policisë.
7. Të merren masa të menjëhershme, për të mosmbajtur në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, sende apo mjete të tilla që ekspozojnë dhunë psikologjike ndaj personave që mbahen dhe trajtohen në këto ambiente.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA